



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3
03.06.2016

NR. VENDIMI 17
31.05.2017

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

Kryesues : Dritan HALLUNAJ
Anëtar : Ardit MUSTAJ
Anëtar : Bib NDRECA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Ankela DAKE**, sot në datën **31.05.2017**, në **Tiranë**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen **nr. 3/14 Akti**, që u përket:

PADITËS: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurorja **Doloreza Musabelliu**.

TË PADITUR:

- 1. F.H (D)**, i datëlindjes XXXX, lindur dhe banues në Elbasan, lagja XXXX, në mungesë, mbrojtur nga Av.B. R. dhe Av. E.H. .
- 2. G.D (alias I.D)**, i datëlindjes XXXXXX, lindur dhe banues në Elbasan, lagja XXXXXX, në mungesë, mbrojtur nga Av. B. R. dhe Av. E. H. .
- 3. P.D**, , i datëlindjes XX.XX.XXXX, lindur në xxxxxx Elbasan, dhe banues në Elbasan, lagja XXXXX, në mungesë, përfaqësuar në gjykim nga Av.B. R. me prokurën e posaçme nr.1382 Rep, nr.745/1 Kol, datë 27.11.2015 dhe Av. E. H. .
- 4. M.D**, , i datëlindjes XX.XX.XXXX, lindur dhe banues në Elbasan, lagja XXXXX, në mungesë, mbrojtur nga Av.B. R. dhe Av.

E. H. .

OBJEKTI: Konfiskimi dhe kalimi në pronësi të shtetit të pasurive:

- Pasuria ne Nr. X/XXX – X, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

- Pasuria ne Nr. X/XXX – Nr.X, Vol.XX, Faqe.XX, e llojit Njësi, me sipërfaqe të rregjistruar 38.54 m2, dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m2. Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

- Pasuria ne Nr. XXX/X, Vol.X, Faqe.XX, e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në prani të:

● **Përfaqësueses së Prokurorisë Për Krime Të Rënda Tirane, prokurores Doloreza Musabelliu që në përfundim kërkoi:**

1. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurisë;

- Pasuria me nr. X/XXX – X, Vol.XX, Fq.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85m2, Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

2. Pushimin e gjykimit dhe kthimin e dy pasurive;

– Pasuria me nr. X/XXX – N.X, Vol.XX, Fq.XX e llojit Njësi, me sipërfaqe të regjistruar 38.54 m2, dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m2. Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

– Pasuria me nr. XXX/X, Vol.X, Fq.XX e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

● **Përfaqësueses të të paditurve F.H (D), G.D (alias I.D), P.D dhe M.D, av. E. H. e cila kërkoi:**

Rrëzimin si të pabazuar të kërkesës për konfiskimin e pasurive, për shkak të ligjshmërisë së prejardhjes së tyre.

Kjo gjykatë pasi dëgjoji kërkimet e palëve ndërgjyqëse dhe shqyrtoi provat e këtij gjykimi në tërësinë e tyre :

VËREN se

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesë-padinë me object, konfiskimin e pasurive në pronësi të të paditurve F.H (D), G.D (alias I.D), P.D dhe M.D, dhe konkretisht:

1. - Pasuria ne Nr. X/XXX – X, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

2. - Pasuria ne Nr. X/XXX – Nr.X, Vol.XX, Faqe.XX, e llojit Njësi, me sipërfaqe të rregjistruar 38.54 m2, dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m2. Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

3. - Pasuria ne Nr. XXX/X, Vol.X, Faqe.XX, e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXX, e rregjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua në mungesë së palës së paditur pasi;

1. **P.D**, pasi me prokurën e posacme nr.1382 Rep, nr.745/1 Kol, datë 27.11.2015, i ka dhënë tagrin e përfaqësuesit ligjor të tij Av.B.R. .
2. Në lidhje me anën e paditur **M.D, F.H (D)** dhe **G.D (alias I.D)**, Gjykata, konform nenit 22 pika 2 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”, duke qenë se këta persona nuk kishin banim të njohur brenda vendit dhe ishin të larguar jashtë vendit, si dhe me gjithë kërkimet e bëra nga ana e policisë, këta persona nuk gjendeshin, ka vendosur mosgjatjen e tyre, dhe u ka caktuar atyre si mbrojtës avokatin B. R. , i cili është mbrojtës i zgjedhur edhe nga babai i tyre, shtetasi P.D, me prokurën nr.355 Rep, nr.120 Kol, datë 30.01.2017.

Gjykimi i kësaj çështje, për shkak të kompleksitetit që paraqiste, periudhës kohore të gjatë që përfshinte në objektin e shqyrtimit të saj, kohës që duhej për njoftimin e të paditurve në këtë gjykim, kohës që ju dha vazhdimisht mbrojtjes për të paraqitur provat, etj, përfundoi në afatin maksimal, një vjeçar të parashikuar për këtë lloj gjykimi nga pika 2 i nenit 23 të ligjit parandalues nr.10192 te vitit 2009.

Kërkimet e palëve dhe provat e shqyrtuara në këtë gjykim:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë në datën 16.11.2015, ka regjistruar procedimin pasuror nr.15 në ngarkim të shtetasve F.H (D), G.D (alias I.D), P.D dhe M.D.

Ky procedim pasuror është regjistruar, pasi me shkresën nr, 2854/13 Prot E.D datë 21.10.2011, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkalles së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, kopjen e akteve të autoriteteve të shtetit të Italisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë në Shqipëri, që ka të bëjë me ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, të shtetasve shqiptarë F.H alias (D), dhe G.D alias (I.D). Po me këtë shkresë është kërkuar fillimi i verifikimeve pasurore për këta shtetas konform ligjit antimafia.

Sipas akteve, ka rezultuar se për shtetasit shqiptarë **F.H alias (D)**, , lindur në XX.XX.XXXX në Elbasan, si dhe ndaj **G.D, alias (I.D)**, lindur në 07.01.1973 po në Elbasan, Ministria e Drejtësisë Italiane në bazë të Konventës Europiane të Ekstradimit të vitit 1957, të Marrëveshjes dypalëshe shtesë të 3 dhjetorit 2007 me Italinë, hyrë në fuqi më datë 01.08.2011, të neneve

489 dhe 492 të K.Pr.Penale, si dhe të neneve 32, 33 të ligjit nr.10193, datë 03/12/2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ka kërkuar ekstradimin e tyre.

Nga aktet e dërguara, rezulton se këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjerin kanë kryer krimin e vrasjes së shtetasit shqiptar A.T në datë 30.03.1998. Gjithashtu përveç krimin të vrasjes, këta shtetas janë deklaruar fajtorë dhe dënuar dhe për krimin e shfrytëzimit të prostitucionit ndaj shtetaseve shqiptare E.P, P.R dhe të një vajze tjetër të thirrur “M”, duke u përcaktuar sesi duhej të kryenin prostitucionin, duke i kontrolluar në vendin e punës, si dhe duke u marrë fitimet nga kjo lloj pune. Krimi i shfrytëzimit të prostitucionit është kryer në Prato, Itali nga dhjetori i vitit 1997 deri në datë 30.03.1998.

Me vendimi, nr.320/98 R.N.R. datë 15.02.2006 të Gjykatës Dytë Penale të Apelit për Krime të Rënda Firence, shtetasit e mësipërm janë dënuar me nga 28 vjet burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.12.2006.

Me urdhërin e Republikës pranë Gjykatës së Firences , nr.1111/2007, SIEP, datë 02.10.2007, është urdhëruar ekzekutimi i dënimeve konkurruese të dhëna ndaj shtetasit F.D. Në këtë urdhër shtetasi F.D përfiton dhe një ulje të dënimit nga amnistia, dhe përfundimisht ky shtetas është dënuar me 25 vjet burgim, po për krimin e vrasjes dhe shfrytëzimit të prostitucionit ndaj disa shtetaseve.

Me urdhërin e Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Firences nr.1111/2007 SIEP , datë 19.10.2007, është urdhëruar ekzekutimi i dënimit të dhënë ndaj shtetasit shqiptar I.D.

Sipas udhrit të ekzekutimin përfundimisht shtetasi I.D është dënuar me 25 vjet burgim, në mungesë, për veprat penale të sipërpërmëndura.

Referuar certifikatave personale rezulton se shtetasi I.D, aktualisht ka gjeneralitetet G.D, i datëlindjes XX.XX.XXXX, lindur në Elbasan, ndërsa shtetasi F.D quhet F.H, i biri i, i datëlindjes XX.XX.XXXX, lindur në Elbasan.

Nga sa më sipër, sipas akuzës provohet se shtetasi **F.H alias (D), dhe G.D alias (I.D)**, janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, sipas nenit 3/1 pikat “d”, pasi rezulton të jenë të dënuar në shtetin italian për veprën penale të “Shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese”, kryer në bashkëpunim, parashikuar si të tillë dhe në nenet 114/a, 25 të Kodit Penal Shqiptar.

Nisur nga sa më sipër në mbështetje të neneve 3 dhe 6 të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” ndaj shtetasit F.H alias (D) dhe G.D, alias (I.D), si dhe personave të lidhur me të që përfshihen në nenin 3 gërma 2 pikat “a” dhe “b” të ligjit nr.10192, date 03/12/2009, është urdhëruar që të kryhen

verifikime në lidhje me identifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të regjistruara në emrin e tyre si dhe të personave të lidhur me ta.

Në këto kushte, nga ana e Prokurorisë, janë kryer verifikime duke dërguar shkresa të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare që disponojnë shtetasit subjekt të hetimit. Gjithashtu me qëllim të identifikimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të aktiviteteve tregtare u është dërguar shkresë Qendrës Kombëtare të Liçensimit, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjensisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Intergrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Nga informacioni i mbledhur nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, dhe i ardhur në mënyrë shkresore, rezulton se:

- Shtetasi P.D figuron i regjistruar në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person fizik me fushë veprimtarie “Bar, Bilardo” i pajisur me NIPT XXXXXXXX, në datën 10.03.2008.

Si dhe se:

- Shtetasi P.M.D ka aplikuar për legalizimin e pasurisë informale (shtesë informale në objekt me leje) pranë Bashkisë Elbasan, Qarku Elbasan. Sipërfaqja totale sipas lejes së miratuar është 39 m2, dhe gjendja faktike e objektit është 52 m2.

Me shkresën Nr.1518/1Prot datë 09.11.2015 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan rezulton se:

- Me kontratën e shitblerjes me Nr.XXXX Rep Nr.XXX Kol datë 26.04.2005, shtetasi P.D ka blerë nga shtetasi S.M pasurinë e paluatshme (ndërtesë – bodrum), e identifikuar me numrin X/XXX – X e ndodhur në Zonën Kadastrale XXXX me sipërfaqe 85m2 në shumën prej 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) Lekë. Nga dokumentacioni i praktikës së regjistrimit të kësaj pasurie rezulton se me vendimin nr.3 të datës 12.03.2001 të KRRT është miratuar leja për ndërtimin e objektit lokal, një kat me dimensione 6.6x15m. në datën 28.05.2012 është miratuar leja e shfrytëzimit për këtë objekt.
- Me kontratën e shitblerjes me Nr.XXXX Rep Nr.XXX Kol datë 26.04.2005, shtetasi P.D ka blerë nga shtetasi S.M pasurinë e paluajtshme (ndërtesë – njësi), e identifikuar me numrin X/XXX – N.X e ndodhur në Zonën Kadastrale XXXX me sipërfaqe 38.54 m2 në shumën prej 800.000 (tetëqind mijë) Lekë.
- Me shkresën Nr.1354/1Prot datë 21.10.2015 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan rezulton e regjistruar në datën 03.06.2014, një pasuri e llojit tokë arë në emër të shtetasit M.P.D. Këtë pasuri ky shtetas e ka fituar me kontratën e shitjes ne Nr.XXXX Rep, Nr.XXX datë 08.05.2013 nga shtetasi

E.D kundrejt çmimit 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.

Pas verifikimeve paraprake të bëra, mbi kërkesën e Prokurorisë për Krime të Rënda, bazuar në Ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë (më poshtë referimi për këtë ligj do të jetë “Ligji parandalues”) Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë (gjyqtarja e vetme) me vendimin nr. 25 datë 23.11.2015 ka vendosur **masën e sekuestros për pasuritë** e mëposhtme:

1. Pasuria me nr. X/XXX – X, Vol.XX, Fq.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85m², Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
2. Pasuria me nr. X/XXX – N.X, Vol.XX, Fq.XX e llojit Njësi, me sipërfaqe 38.54m², Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
3. Pasuria me nr. XXX/X, Vol.X, Fq.XX e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m², Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

Pas këtij vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, është vijuar me hetimin pasuror dhe me datë 03.06.2016, pranë kësaj gjykate ka ardhur për gjykim kërkesa e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë me object, konfiskimin e pasurive në pronësi të të paditurve F.H (D), G.D (alias I.D), P.D dhe M.D, e konkretisht:

1. - Pasuria ne Nr. X/XXX – X, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85 m², Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
2. - Pasuria ne Nr. X/XXX – Nr.X, Vol.XX, Faqe.XX, e llojit Njësi, me sipërfaqe të rregjistruar 38.54 m², dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m². Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
3. - Pasuria ne Nr. XXX/X, Vol.X, Faqe.XX, e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m², Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

Në gjykimin e kësaj kërkesë nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, për të provuar pretendimin e tyre u paraqitën dhe u shqyrtuan provat e mëposhtme;

- Urdhër për regjistrimin e procedimit pasuror nr.15 të datës 16.11.2015.
- Shkresa Nr.2854/13 datë 21.10.2011 e Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, për fillimin e hetimit pasuror ndaj shtetasve F.H (D), G.D (I.D).Bashkëlidhur shkresës ndodhen ;

-vendimi nr.320/98 R.N.R. datë 15.02.2006 të Gjykatës Dytë Penale të Apelit për Krime të Rënda Firenze, ku rezulton që shtetasit F.H (D) dhe G.D (alias I.D), janë dënuar me nga 28 vjet burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë, në datën 12.12.2006.

-Vendimi i prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Firences, nr.1111/2007, SIEP, datë 02.10.2007, për ekzekutimin e dënimeve konkurruese të dhëna ndaj shtetasit F.D

-Urdhëri i Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Firences nr.1111/2007 SIEP

, datë 19.10.2007, për ekzekutimin e dënimit të dhënë ndaj shtetasit shqiptar I.D .

-Materiali identifikativ me fotografi i shtetasve F.D dhe I.D si dhe kartelat daktiloskopike të tyre, material i transmetuar nga autoritetet italiane të drejtësisë me shkresën nr. N/Rif . nr. UCI/ALB/LR785/08/FR Prot datë 14.10.2011 të Zyrës se Interforzës Tiranë.

-Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 359/7 Prot /I.H datë 12.10.2011, “Mbi ekstradimin nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të shtetasve F.H(D) dhe G.D alias (I.D), nga rezulton se këta dy shtetas janë arrestuar me qëllim ekstradimin.

- Vendimi nr. 25 datë 23.11.2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për sekuestrimin e pasurive në emër të shtetasve P.D dhe M.D, si dhe vendimin nr.01 datë 06.01.2016 të Gjykatës së Apelit të krimeve të rënda Tiranë që ka vendosur mospranimin e ankimit.
- Shkresë nr.785 Prot datë 17.12.2015, e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, që konfirmon zbatimin e vendimit të gjykatës për dy pasuritë: lloji Podrum, dhe lloji arë.
- Shkresë nr.10 Prot datë 06.01.2016, e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, që konfirmon zbatimin e vendimit të gjykatës për pasurinë njësi, ku specifikohet se ky objekt shërbente si ambient banimi i kompozuar në dy dhoma gjumi, kuzhinë, korridor , ballkon dhe një banjë, i mobiluar.
- Shkresa Nr.2181-K/2Prot. datë 08.11.2011, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Shkresa Nr.5960/1Prot. datë 21.11.2011, e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- Shkresa Nr.815Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë.
- Shkresa Nr.3881/1Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë.
- Shkresa Nr.2972/1Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë.
- Shkresa Nr.2105/1Prot. datë 26.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat.
- Shkresa Nr.3650/1Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.
- Shkresa Nr.885Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Has.
- Shkresa Nr.1952/1Prot. datë 30.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës.
- Shkresa Nr.893/1Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat.

- Shkresa Nr.4822/1Prot. datë 09.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër.
- Shkresa Nr.1853/1Prot. datë 05.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë.
- Shkresa Nr.1213/1Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh.
- Shkresa Nr.2214Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kuçovë.
- Shkresa Nr.11543/1Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.
- Shkresa Nr.1534/1Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë.
- Shkresa Nr.7538/1Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.
- Shkresa Nr.1161Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kolonjë.
- Shkresa Nr.1037Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin.
- Shkresa Nr.2690Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd.
- Shkresa Nr.1064/1Prot. datë 24.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Dibër.
- Shkresë nr.1102/Prot datë 23.11.2011, e N/Prefekturës së rrethit Devoll.
- Shkresa Nr.1829Prot. datë 23.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mirditë.
- Shkresa Nr.1572Prot. datë 23.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe.
- Shkresa Nr.1019/1Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mallakastër.
- Shkresa Nr.965/1Prot. datë 01.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë.
- Shkresa Nr.724/1Prot. datë 30.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Peqin.
- Shkresa Nr.3443/1Prot. datë 25.11.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier.
- Shkresa Nr.682/1Prot. datë 04.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë.
- Shkresa Nr.2440/1Prot. datë 04.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë.
- Shkresa Nr.4975/1Prot. datë 13.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës.
- Shkresa Nr.2193/1Prot. datë 01.12.2011, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, nga ku rezultojnë pasuritë objekt konfiskimi,

në emër të P.D dhe M.D. Bashkëlidhur janë 3 kartelat e pasurive të paluajtshme,

- Shkresa Nr.1354/1Prot. datë 21.10.2015, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, me atë të cilës është dërguar praktika e regjistrimit të pasurisë nr.XXX/X regjistruara në volum X faqe XX zk.XXXX ne emër të M.P.D.

Aktet e dërguara janë ;

-Kartela e pasurise se sipërcituar, nga ku rezulton se pasuira është regjistruara në datën 03.06.2014 ne emër të M.P.D

-Harta treguese e regjistrimit

-Kontratë shitje datë 08.05.2013, nga ku rezulton se shtetasi M.D ka blerë prej shtetasi E.D një tokë arë me sipërfaqe 3000 m2 ndodhur në Elbasan, në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë.

-Certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar nga Z.R.P.P. Elbasan datë 05.05.2014.

-Kartela e kësaj pasurie.

-Plan Rilevimi.

- Shkresa Nr.1518/1Prot. datë 09.11.2015, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan, me anë të të cilës janë dërguar fotokopje të praktikav të regjistrimit për pasuritë X/XXX –X dhe X/XXX N.X në pronësi të shtetsit P.M.D ku midis të tjerave përfshihen:

-Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme datë 26.04.2005 me palë shitëse S.M dhe palë blerëse P.M.D, me objekt shitjen e pasurise X/XXX –X (ndërtesë- Podrum) , sip 85 m2, në vlerën 1.800.000 (një million e tetëqind mije lekë).

-Harta treguese e regjistrimit të kësaj pasurie

-Kontratë shitblerje datë 26.04.2005, me palë shitëse S.M dhe palë blerëse P.M.D, me objekt shitjen e pasurise X/XXX N.X (ndërtesë- njësi) , sip 38.54 m2, në vlerën 800.000 (tetëqind mije lekë)

- Shkresa Nr.21830/1Prot. datë 05.12.2011, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Shkresa Nr.30741/1Prot. datë 15.12.2011, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës.
- Shkresa Nr.9038/1Prot. datë 04.01.2012, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan.
- Shkresa Nr.17175/1Prot. datë 29.11.2011, e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Shkresa Nr.8490/1Prot. datë 02.12.2011, e Agjensisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, nga rezulton se P.D ka aplikuar për legazimin e shtesës së banesës, pasurisë me numër X/XXX – N.X, Vol.XX, Fq.XX e llojit Njësi, me sipërfaqe 38.54 m2, Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D, ku gjendja

faktike sipas deklarimit është pas shtesës së bërë është 52 m 2.

- Shkresa NR. 483/1 Prot datë 06.10.2011, Agjensisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale.
- Shkresa Nr.3840/1Prot. datë 30.11.2011, e Qendrës Kombëtare të Liçencimit.
- Shkresa Nr.18811/1Prot. datë 24.11.2011, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Shkresa Nr.8825/1Prot. datë 06.12.2011, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Shkresa Nr.9269/1Prot. datë 25.11.2011, e Bankës Kombëtarë Tregtare.
- Shkresa Nr. Ref:4092/2011 datë 21.11.2011, e Bankës së Kreditit të Shqipërisë.
- Shkresa Nr.Prot.24384. datë 08.12.2011, e Tirana Bank.
- Shkresa Nr.11/12691/1Prot. datë 24.11.2011, e Intesa SanPaolo Bank.
- Shkresa Nr.2283Prot. datë 24.11.2011, e Union Bank.
- Shkresa Nr.Prot.19472/1. datë 30.11.2011, e Bankës Societe Generale Albania.
- Shkresa Nr. Ref:289-11-OS datë 23.11.2011, e Emporiki Bank.
- Shkresa Nr.13697Prot. datë 23.11.2011, e Credins Bank.
- Shkresa Nr.8685Prot. datë 21.11.2011, e Alpha Bank.
- Shkresa Nr.Prot. ON-A-5839/2011datë 21.11.2011, e First Investment Bank, nga rezulton se në këtë bank shtetasi P.M.D ka llogari page me numër NR. AL XX XXXX XXXX all 1 0000 0177 6700 , ku i kalon pagesa e përmuajshme e asistencën mjekësore nga Bashkia Elbasan , prej 2'700 lekë.
- Shkresa Nr.010433 datë 18.11.2011, e Bankës Kombëtare të Greqisë.
- Shkresa Nr.12338/1Prot. datë 22.11.2011, e Raiffeisen Bank.
- Shkresa Nr. Ref:4702/11 datë 21.11.2011, e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.
- Shkresa nr. 3077 Pot datë 21.11.2011, e Bankës Ndërkombëtare Tregëtare
- Shkresa nr. 098858/1 datë 22.11.2011, e Bankës Pro Credit
- Shkresa nr. 7229/1 Prot datë 22.11.2011, e Veneto Bank.
- Certifikata lindje dhe familjare të të paditurve.

Të paditurit në gjykim, e kundërshtuan kërkesën për konfiskimin e pasurive të zotëruara prej tyre, duke pretenduar ligjshmërinë e prejardhjes dhe justifikimin e tyre me të ardhurat e ligjshme të përfituara nga puna e tyre dhe familjarëve të tyre, pasi ajo është një familje e madhe, me shumë pjesëtarë, të cilët gjithmonë kanë qenë në marrëdhënie pune, si dhe nga marrja e disa shumave monetare nga kompanitë e sigurimeve jashtë Shqipërisë në aksidentet e ndodhura familjarëve të tyre.

Nga ana e mbrojtjes në gjykim u paraqitën si prova një shkresë e Bankës së Romës që kishte të bënte me transfertën e një shume prej 90.000 Euro e datës 16.08.2006, që kishte të bënte me një dëmshpërblim të përfutur nga vdekja e shtetasit A.D (djali tjetër i shtetasit P.D) në Itali, por që nga gjykata nuk u pranua si provë, pasi nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji. Megjithëse nga ana e gjykatës ju krijua mundësia që mbrojtja të siguronte një akt të tillë në rrugën e duhur ligjore apo në formën e kërkuar nga ligji, një gjë e

tillë nuk u realizua nga mbrojtja. Ata kërkuan investimin e gjykatës në këtë drejtim, por gjykata konform nenit 21 pika 3 të ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, si dhe nenit 12 të K.Pr.Civile, rrëzoi kërkesën e palës së paditur që gjykata të merrte rol aktiv, pasi sipas kësaj dispozite, barra e provës është e personit kundër të cilit kërkohet konfiskimi.

Pas shumë seancave gjyqësore që të paditurve ju la në dispozicion nga gjykata për paraqitjen e provave, ato paraqitën disa prova shkresore në lidhje me pretendimet e tyre, konkretisht:

- Certifikata familjare e datës 08.03.2017, e shtetasit P.D dhe V.D.
- Certifikatë vdekje e datës 08.03.2017, me të cilin vërtetohet vdekja e A.D, i cili ka vdekur në datë 26.11.2004.
- Një dokument me vulë apostile, të lëshuar nga shteti grek, që bën fjalë për një dëmshpërblim të përfituar nga shtetasi J.D, nga siguracioni i automjeteve si rezultat i një aksidenti me automjet, në shumën 11.608.11 euro, të marrë në datën 10.08.2005.
- Një vërtetim nga Shoqëria Kursim Krediti Albprogres, nga i cili rezulton se shtetasja V.P.D, ka marrë dy kredi në këtë institucion në datat 21.03.2013 dhe 15.10.2015, përkatësisht në shumat 500.000 dhe 1.000.000 lekë
- Një kopje libreze pune të shtetasës V.D, nga e cila rezulton se ka filluar si punë si edukatore kopshti në datën 26.09.2005, dhe një vërtetim nga Bashkia Elbasan, nga rezulton se kjo shtetase aktualisht është punonjëse pranë shkollës 9 vjecare ‘XXXX’ me detyrë edukatore, dhe ka pagë neto 44.915 (dyzetë e katër mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë)lekë.

Gjatë hetimit gjyqësor të çështjes pala e paditur paraqiti provat e sipërcituara të cilat u bënë pjesë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes dhe pas analizimit të tyre, përfaqësuesja e anës paditëse, Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, duke cmuar se me këto akte të servitura nga ana e paditur, justifikohet burimi i ligjshëm i blerjes së dy pasurive dhe konkretisht i:

1. Pasurisë me nr. X/XXX – N.X, Vol.XX, Fq.XX e llojit Njësi, me sipërfaqe 38.54m², Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P. M. D. , e blerë në datën 26.04.2005 për vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, dhe
2. Pasurisë me nr. XXX/X, Vol.X, Fq.XX e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m², Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit M.P.D e blerë në datën 21.10.2015, në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë,

kërkoj që të hiqte dorë nga gjykimi i padisë për këto pasuri, duke kërkuar pushimin e gjykimit, dhe kthimin e këtyre pasurive palës së paditur, duke revokuar kështu dhe vendimin nr.25 datë 23.11.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë “Për sekuestrimin e pasurive”.

Për këtë kërkim, pala paditëse e argumenton se dy pasurite e sipërcituara në vlerën

totale 2.400.000 lekë, justikohen:

Së pari, nga shuma prej 11.608.11 euro e përftuar nga shetasi J.D në Greqi, i dokumentuar kjo me dokumentin përkatës me vule apostile.

Së dyti, nga vërtetimi për kreditë e marra nga shtetasja V.D, provohet se është marrë kredi shuma në total 1.500.000 lekë, e cila justifikon dhe vlerën e tokës arë, me vlerën 1.600.000 lekë.

Dhe **së treti**, nga vërtetimi për pagesën e shtetasës V.D, dhe nga librezja e punës së saj, se ka filluar punë si edukatore në shtator të vitit 2005, dhe ka marrë pagesën prej 44.915 (dyzetë e katër mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

Ndërsa në lidhje me pasurinë me numrin X/XXX – X e ndodhur në Zonën Kadastrale XXXX me sipërfaqe 85m2, e blerë në shumën prej 1.800.000 (një milion e tetëqindmijë) lekë, pala pasditëse Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë **kërkoj konfiskimin e saj**, pasi çmori se nga provat e grumbulluara në analizë dhe të provave të paraqitura nga pala e paditur nuk u arrit të justifikohet burimi i ligjshëm i saj.

Vlerësimi i gjykatës:

Gjykata në lidhje me sa kërkohët nga palët, ka parasysh Ligjin nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", Kodin e Procedurës Civile dhe llojin e gjykimit të këtyre kategori çështjesh.

Së pari, objekt i këtij gjykimi, dhe kjo gjykatë e gjen të drejtë pretendimin e Prokurorisë për Krime të Rënda, se të paditurit F.H(D) dhe G.D(alias I.D), dhe familjarët e tyre, janë subjekte të ligjit parandalues nr. 10192 datë 03.12.2009 në zbatim të **nenit 3/1 pikat "ç" dhe nenit 3/2, pika "a"** të këtij ligji.

Në gjykim u provua plotësisht se shtetasit e paditur në këtë proces F.H(D) dhe G.D(alias I.D), me vendimin nr.320/98 R.N.R, datë 15.02.2006 të Gjykatës së Dytë Penale të Apelit për Krime të Rënda Firenze, Itali, janë deklaruar fajtorë ndër të tjera edhe për kryerjen e veprës penale të "Shfrytëzimit të prostitucionit", parashikuar nga neni 114 dhe 25 i Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë, në datën 12.12.2006.

Fakti penal për të cilin të paditurit janë dënuar përkon me periudhën nga muaji dhjetor i vitit 1997, deri në datë 30.03.1998.

Së dyti: Nga aktet dhe provat e paraqitura në këtë gjykim, provohet se pasuria objekt konfiskimi është krijuar: 2(dy) pasuri në datën 26.04.2005 dhe 1(një) pasuri me datë 08.05.2013, pra janë pasuri të krijuara pas periudhës kur provohet se të paditurit F.H(D) dhe G.D(alias I.D), kanë qënë të përfshirë në veprimtari kriminale (objekt zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009, sipas nenit 3/4 të tij).

Në këto kushte e gjithë pasuria objekt i kërkesës për gjykim, përfshihet në pasuritë që duhet t'u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin parandalues duke patur personat

zotërues të saj, të paditurit, barrën e provës të justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit 21/3 të ligjit parandalues.

Pasuritë objekt konfiskimi janë si më poshtë vijon:

1. - Pasuria me Nr. X/XXX – X, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

2. - Pasuria me Nr. X/XXX – Nr.X, Vol.XX, Faqe.XX, e llojit Njësi, me sipërfaqe të rregjistruar 38.54 m2, dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m2. Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.

3. - Pasuria me Nr. XXX/X, Vol.X, Faqe.XX, e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

Gjatë gjykimit, palët ndërgjyqëse, si pala paditëse Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, edhe ana e paditur paraqitën prova të cilat u shqyrtuan dhe u analizuan nga gjykata.

Në përfundim të gjykimit, pala paditëse, Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, e cila disponon padinë, duke çmuar se me provat e paraqitura nga ana e paditur, justifikohet burimi i ligjshëm i blerjes së dy pasurive dhe konkretisht i:

1. Pasurisë me nr. X/XXX – N.X, Vol.XX, Fq.XX e llojit Njësi, me sipërfaqe 38.54m2, Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D, e blerë në datën 26.04.2005 për vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, dhe
2. Pasurisë me nr. XXX/X, Vol.X, Fq.XX e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit M.P.D e blerë në datën 21.10.2015, në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë,

hoqi dorë nga gjykimi i padisë për këto pasuri, duke kërkuar pushimin e gjykimit, dhe kthimin e këtyre pasurive palës së paditur, duke revokuar kështu dhe vendimin nr.25 datë 23.11.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë “Për sekuestrimin e pasurive”.

Megjithëse gjykata vlerëson të drejtë qëndrimin e paditësit për këtë kërkim, pasi dy pasurite e sipërcituara në vlerën totale 2.400.000 lekë, justikohen;

Së pari, nga shuma prej 11.608.11 euro e përftuar nga shtetasi J.D në Greqi, i dokumentuar kjo me dokumentin përkatës me vulë apostile.

Së dyti, nga vërtetimi për kreditë e marra nga shtetasja V.D, provohet se është marrë kredi shuma në total 1.500.000 lekë, e cila justifikon dhe vlerën e tokës arë me vlerën 1.600.000 lekë.

Dhe **së treti,** nga vërtetimi për pagesën e shtetasës V.D, dhe nga librezja e punës së saj, se ka filluar punë si edukatore në shtator të vitit 2005, dhe ka marrë pagesen prej 44.915 (dyzetë e katër mije e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

Gjykata, ka parasysh këtu nenin 201 të K.Pr.Civile, ku shprehimisht thuhet se:

“Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

Prandaj sa më sipër çmon të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes për pjesën e dy pasurive: 1) Pasurisë me nr. X/XXX – N.X, Vol.XX, Fq.XX e llojit Njësi, dhe 2) Pasurisë me nr. XXX/X, Vol.X, Fq.XX e llojit Arë.

Në lidhje me pasurinë me Nr. X/XXX – B, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Bodrum, me sipërfaqe 85 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D, gjykata çmon se nga ana e paditur nuk u arrit të provohet burimi i ligjshëm i saj.

Duke qenë se konform ligjit antimafia, barra e provimit të ligjshmërisë së pasurive i përket palës së paditur, dhe kjo e fundit, për këtë pasuri, nuk arriti të justifikonte ligjshmërinë e burimit të krijimit, nga ana e gjykatës krijohet bindja se pasuria me nr. X/XXX – X, Vol.XX, Fq.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85m2, Zona Kadastrale XXXX, e regjistruar në emër të shtetasit P.M.D, e blerë me vlerën 1.600.000 lekë, është blerë me të ardhurat nga aktiviteti kriminal i shtetasve F.H dhe G.D.

Kjo pasuri është fituar nga personi i lidhur me personat e hetuar **F.H alias D dhe G.D, alias I.D,** (babai) pas përfshirjes të të tyre në veprimtarinë kriminale të shfrytëzimit të prostitucionit.

Pavarësisht se kjo pasuri është vënë në vitin 2005 përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", ky ligj do të zbatohet, konform nenit 3/4 i ligjit, pasi ai i shtrin efektet dhe për pasuritë e vëna përpara hyrjes në fuqi të tij pasi pasuritë janë vënë gjatë dhe pas përfshirjes në veprimtari kriminale.

Përfundimisht duke vlerësuar se pasuria me Nr. X/XXX – X, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D, që plotëson kriteret për konfiskim nuk ka prejardhje të ligjshme, gjykata gjen të drejtë kërkesën e palës paditëse për të konfiskuar këtë pasuri.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar nenet 3, 7/2,12/5 21-28, të ligjit Nr.10192, date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”i ndryshuar, nenet 126, 306 – 310 të K.Pr.Civile,

VENDOSI

1. Pranimin e padisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.
2. Konfiskimin dhe kalimin në pronësi të shtetit të pasurive të paluajshme :
 - Pasuria me Nr. X/XXX – X, Vol.XX, Faqe.XXX, e llojit Podrum, me sipërfaqe 85 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
3. Pushimin e gjykimit të kërkesës së Prokurorisë Për Krime Të Rënda Tiranë për konfiskimin e pasurive të mëposhtme:
 - Pasuria me Nr. X/XXX – Nr.X, Vol.XX, Faqe.XX, e llojit Njësi, me sipërfaqe të rregjistruar 38.54 m2, dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m2. Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
 - Pasuria me Nr. XXX/X, Vol.X, Faqe.XX, e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit M.P.D.

4. Revokimin e vendimit nr. 25 datë 23.11.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë “Për sekuestrimin e pasurive”, dhe heqjen e sekuestros për:
- Pasurinë me Nr. X/XXX – Nr.X, Vol.XX, Faqe.XX, e llojit Njësi, me sipërfaqe të rregjistruar 38.54 m2, dhe me gjendje faktike pas shtesës 52 m2. Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit P.M.D.
 - Pasurinë me Nr. XXX/X, Vol.X, Faqe.XX, e llojit Arë, me sipërfaqe 3000 m2, Zona Kadastrale XXXX, e rregjistruar në emër të shtetasit M.P.D.
5. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra Përmbartimore Elbasan, dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratorja pranë këtij institucioni, znj.Englantina Osmanlli.
6. Urdhërohet kryesekretaria pranë kësaj gjykate, që t’i komunikojë një kopje të këtij vendimi Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, si dhe Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Elbasan.
7. Shpenzimet hetimore të hetimit pasuror, shpenzimet gjyqësore (sipas formularit përkatës), i ngarkohen të paditurve P.D, F.D, G.D dhe M.D.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ankim i cili nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 31.05.2017.

SEKRETARE

ANKELA DAKE

GJYQTAR

DRITAN HALLUNAJ

